



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË · OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjencë Më/Dana 13-11-2023

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetësi Prilog	Vlera Vacknost
	01-060/01-		1396



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të Nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **X** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datën **21.11.2023 (e martë), në ora 10:00**.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.


Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2024.
3. Informatë nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit rreth procesit të legalizimit në Komunën e Vitisë.
4. Informatë nga Drejtoria për Bujqësi për planin operativ për mbjelljet vjeshtore për vitin 2023-2024.

Viti, më 13.11.2023

Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E NËNTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **18.10.2023 (e Merkurë)** në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, znj.Zejnepe Osmani, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Faleminderit që ju keni përgjigj ftesës! Të nderuar antarë të komitetit, të gjithë të pranishmit që jeni në këtë takim. Materilian e keni marrë me kohë, ndërsa pjesa e konfirmimeve të ligjshmërisë nuk ka pas ndonjë ndryshim prej seancës së fundit, pjesa tjetër, më herët i kemi pasë informata cilat janë para se të hymë në rend të ditës unë e kisha hapë diskutimin.

z.Illir Zuka: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Para se të hy në kërkes, siç jeni të informum, drejtori i bujqësisë është me shëndet të ligë, i uroj shërim, uroj të kthehet sa më shpejtë, një lajm për ne që kemi punu kemi qenë bashkëpunor të ngushtë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ka qenë një bashkëpunor i të gjithëve një kohë të gjatë që kemi punu bashkë, së paku në 3 mandate kemi qenë. E di se sot udhëton për Francë, i urojmë të gjitha të mirat dhe sa më lehtë t'i kalojë këto sfida. Ka qenë dje edhe në Viti, është përshëndet me një pjesë që i ka taku dhe nuk e pata fatin me taku unë, por kontaktova me telefon dhe u përshëndeta.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë si përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje i shpreh shumë shëndet drejtorit për bujqësi. Tash jam 2 mandate me të cilin ne kemi bashkëpunim dhe uroj që të kalojë sa më mirë. Nuk paskam pas informacione për këtë, tani e morra vesh dhe ne jemi prekur jashtëzakonisht shumë prej këtij lajmi që na dha Illiri. Uroj të kthehet shëndosh e mirë! Sa i përket diskutimit jashtë pikave të rendit të ditës, nëse e keni lexu procesverbalin e mbledhjes së kaluar, kam kërku me pas një informata prej DKA-s për fillimin e procesit mësimor. Çështja tjetër ka të bëjë për komisionin për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave për Komunën e Vitisë. Ky komision është i formuar në Kuvend. Anëtarë kemi zgjedhë mandatin e kaluar, e kemi pasë fillu një praktikë jo të hijshme që nuk e kemi mbajtur asnjë mbledhje të vetme. Koha po kalon, shkuan 2 vite të këtij mandati, po më intereson me ditë kur kanë me fillu procedurat për këtë komision. E njëjta punë vlenë që po më intereson me ditë nënkryetarë, tek administratorët e fshatrave të Komunës së Vitisë. Kam parë që, në disa komuna janë përfunduar procedurat e zgjedhjes së administratorit të fshatrave. Dua ta di te ky proces si komunë si qëndrojnë. Nëse nuk gabohem, mandati ju ka kaluar dhe dua ta di kur fillojnë procedurat.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Tek komisioni që e kemi formuar për emërtimin e rrugëve, komisioni është, ne vetëm duhet me mbledh komisionin me caktu dikë përgjegjës dhe me vazhdu procedurat. Këtë mund ta bëjmë në bashkëpunim me sekretarin e Kuvendit.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! E bashkëndej dhe unë dhimbjen për kolegun tonë, i uroj të gjitha të mirat dhe ta kalon këtë sfidë. Liridonë, komisionet duhet të funksionalizohen, por megjithatë në shqyrtim të kërkesave të ndërrimit të emrave, diku ende 2 vite i ka që kanë hy në sistem të Agjencionit të Kadastarit të Kosovës, dhe çdo rrugë e emërtuar tani momentalisht duhet

rrugë të reja të cilat kanë nevojë të emërtohen. Edhe rrugët e reja të cilat duhet me u formu dhe i plotësojnë kriteret ligjore, nuk mund të propozohen emrat perveq mi marrë nga emrat të cilat janë në rezervë. Është mirë që qytetarit të ju shpjegohet. Ndoshta kur të ju shpjegohet në këtë formë, ata nuk insistojnë me kërkesa. Ju që jeni anëtarë të komisionit, Besoj që këtë punë duhet me u kompletu me dokumentacionin përkatës normativ që e rregullon këtë çështje te Sadati, dhe të jenë qytetarët të njotuar, që të mos ju bëjnë as juve presion e as ekzekutivit, për shkak se kjo çështje është e rregulluar kështu. Tek zgjedhja e kryetarëve të këshillave të fshatrave, unë e di që shumë komuna i kanë zgjedhë pas neve, nuk e kam kqyr saktësishtë rregulloren a ju ka kalu mandati. Në rastë se ju ka kalu, atëhere duhet ta formojmë një komision i cili është komision miks. Do të jetë prej Kuvendit dhe prej ekzekutives, edhe pse jam skeptik sa i përket çështjes, për shkak të mos vendimit pozitiv të tyre në aspekt të mbulesës, bile të shpenzimeve, por megjithatë ne duhet t'i hymë procedurës dhe duhet t'i zgjedhim.

z.Illir Zuka: Unë vazhdoj me problemet e njëjta, se kam qenë pardje tek nënkryetari, por kam pritë sot se është njerëzore Jakup Demiri me më kërku falje publikisht që më ka etiketu me emër atë ditë në kuvend Ilir Zuka a është ankues Shpend Musa. E kam pritë, se me siguri e ka ditë rrjedhë se çka ka ndodhë për 1 javë dhe ki informacion se çka ka ndodhë për 1 javë. E ka parë kush u kanë gabim dhe me siguri e dinë që OSHP-ja ia ka kthyer sekretarëshes prapë. I ka thanë që keni qenë gabim, se nuk ka pas ankesë. Kam shpresu të paktën për një kërkim falje atë ditë, nuk kam dashtë për hirë të kamerave me folë, se nuk jam njeri që kqyr me fitu poena politik në kamera. Vetëm po të tregoj që, Shpend Musa qe 10 vite është kryetar i klubit të "Vllaznisë" dhe i ka hargju nja 400 mijë euro, 400 mijë euro janë shumë o Jakup Demiri, që kqyr me etiketu për një gjë që nuk e ka bërë. Nuk dua ta mbrojë, se ai i ka punët e veta, ai punon me biznes. Realisht me kqyrë sa mua ose Shpendin e keni dëmtu njerëzit e caktum në Pozheran me etiketim, plus që zgjedhjet e ardhshme mos ta kapni bartësin e listës, të hyni në vota edhe do ta shohim sa vota do ti merrni.

z.Jakup Demiri: Ilir, për punët e Shpendit kurr në jetë nuk kam fol, jam mundu me ruajtë, ti e dinë mirë kush është ankuesi, ankuesi është "Nika pro inxhinier SHPK", pronar Shpend Musa, ky do të thotë është më i shtrenjti se 4 kompanitë që kanë konkuru, nuk është i dyti, por më i shtrenjti dhe i vetmi është ky që është anku, por pasi që ka qenë shkolla e Pozheranit, ka qenë mirë të paktën me bisedu, se ai ashtu kshtu nuk e fiton, po i bjen në një formë sikur me blloku punën. Ne gjithë këtë angazhim e kemi pas krejtë dhe besoj që unë nuk kam thanë asnjëhere që komuna nuk i ka dhanë zorë ose ne i kemi pas përfaqësuesit e keq si deputet që i kemi votu për këtë shkollë, të paktën i kemi dhanë zorë krejtë, por juve si Pozheran ju ka taku, masi është ai i Pozheranit, të paktën një here me bisedu, ta kam bërë me dije edhe kështu pa e bërë publikisht, që sot të ofroj edhe argumente. Fituesi është me 739 mijë euro, do të thotë është i pari, i dyti, është me 785 mijë euro, i treti është 829 mijë euro, i katërti është 859 mijë euro, ndërsa ky qenka i 5-ti, është me 938 mijë euro. Do të thotë është i 5-ti në rend që e ka qu lëndën në OSHP dhe është blloku kjo kompani e tij, vetëm kjo është anku për atë kisha me bisedu me të. Nuk po themë që me shti me u terhek, por të paktën me bisedu dhe ndoshta ai e kish hekë këtë ngërq që po na e merr kohën.

z.Illir Zuka: Në takimin dje që e kemi mbajttë në Prishtinë, lënda prej OSHP-së është kthyer përsëri tek ministri. Me siguri jeni informu se jeni të atij subjekti.

z.Fatulum Demiri, sekretar i Kuvendit Komunal: E kam Vendimin me 10.11. OSHP-ja ka marrë vendim, anulohet ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim.

z.Illir Zuka: Do të thotë u aprovu ankesa si e ligjshme. Ju kthehet që, kompania nuk ka të drejtë për shkak që nuk i ka plotësu kushtet. Nuk dua me mbrojtë atë, por në mënyrën se si më ka etiketu dhe politika që është bërë për 1 javë me emrin tem nga njerëzit e caktuar, është bërë shumë e padrejtë. Për mua e dinë Pozherani, e dinë kush jam unë, e dinë sa i jap zor. Nuk mundet me më dëmtu në atë mënyrë me më përdor në Kuvend, në mënyrën se si ka ndiku. E dinë sakt se si ka reagu, Ilir Zuka dil kallzoi a është Shpend Musa, por e dinë edhe problemi tek ky vendim. Këtë është dashtë me lexu jo ankesën, por mirren për shkak të këtij problemi. Jakup, po të tregoj tashti LDK dhe PDK na ka lanë 2016 pa shkollë, se e ka marr një kompani jo serioze. Përsëri u kanë tu ndodhë e njëjta punë, për shkak të pazareve. Na e dimë 2016 deri në 2020 na keni thanë, LDK-ja na ka lanë pa shkollë, vendimin e ka marr OSHP-ja që e keni themelu ju.

z.Jakup Demiri: Qekjo kompani që është anku është e pesta. Tashti ju ndoshta edhe keni bisedu me ta, po kurrë nuk ke thanë që jemi taku me ta e e kemi sqaru.

z.Illir Zuka: Jakup, a ka qenë etike me thanë ti. Atë ditë në Kuvend ki thanë: "Ilir Zuka, dil kallëzoju a është Shpend Musa ankuesi". Krejt Pozherani e dinë si keni votu ju me qu stadiumin në Sadovinë, e krejt i

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Unë po mendoj që, gjithëherë një politikë, një sistem i rregulluar jo mirë është konstatim i imi dhe na qet punë këtu neve me bisedu, me hupë kohë që ne nuk mujm me bë asgjë në atë drejtim e drejta e ankesës njëherë e përgjithmon ka qenë edhe është e drejtë kushtetuese. Mjerimi më i madhë që e shtrojmë në Kosovën tonë të dashur, me shku me bisedu pse je anku, cilat janë mënyrat dhe forma d.m.th përshpejtimin të procedurave dhe i vendosjes së problemit. Këtë qasje nuk e kanë pas. Ajo çka është emruesi i përbashkët që na bashkon gjithë spektrin politikë, në pamundësi për me bë diçka më shumë, është se, jemi të interesum me përfundu shkolla e Pozheranit. Neve nuk janë tu na vetë, atë nuk e ka prur Albin Kurti, ka qenë edhe në kohën e LDK-së edhe të PDK-së, por ky sistem i rregullim të aspektit ligjor është i mbrapsht. Unë kam qenë në mbledhje dhe i kam thanë Albin Kurtit që duhesh me marrë hapa me ndryshu. Ne kemi qenë unanim që u pajtu edhe kryeministri së bashku me ministra që me marrë hapa konkret, se koha tash e ka dëmtu këtë çështja që duhet me marrë hapa më efikas për zhvillim edhe të procedurave që tani e zhvillon edhe ekonominë, arsimin. Prandaj mos të hupim kohë me këtë, nuk mundet me ja cenu të drejtën. Unë e di që ti the nga aspekti moral dhe shoqëror, por po mendoj se lufta jonë edhe në nivel komunal dhe qendror duhet me bë luftë me rregullu sistemin. Ky sistem efikas dikush është më i mirë, po me rëndësi. Në fund kanë me i qitë krejt, e ky sistem jemi tu e pa që është jo funksional. Unë besoj se atë ditë jemi dakordu në mesin e 38 përfaqësuesve të komunave. Të gjithë kanë qenë që këtë çështje duhet me marrë kryeministri, edhe ai u pajtu me kabinetin e vetë me përshpejtu këtë çështje. Unë vetëm këtë çështje e kam ngritë. Kam thanë, në rastë se i ngriti 3 tema për komun, anashkalohet shkolla e Pozheranit. Kam thanë, kryeministër përdore autoritetin tëndë, përfundoje shkollën në Pozheran. Asnjë fjalë nuk e kam thanë më shumë, kam pas tema që ndoshta kanë qenë të nevojshme, por në rast se shtimë tema tjera po e minimizoj këtë.

z.Jakup Demiri: Edhe me grupin parlamentar jemi me një vi me 2 deputetët tanë të cilët kanë kërku prej kryeministrit, që shkolla e Pozheranit të merrë epilog. Ashtu si e ke pas ti një rekomandin tek kryeministri, atë e kanë pas edhe javën e kalume 2 deputetët.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Me qenë Hasan Aliu, ndesh ne të jetë Lumiri ndesh Albini nuk ta votoj buxhetin në rast se nuk e përfundon shkollën në Pozheran, përjashtom prej partisë nesër. Askush nuk e ka ndalu, në këtë rast kryeministrin e di që ai nuk i ka fajet, por ministrat i kanë që duhet me tregu realitetin. Ata janë këshilltarët e atij me thanë që këtë gjendje e kemi kryeminister. Tani ka politika dhe probleme shumë më të mëdha se një shkollë e Pozheranit, me thanë në procedur të negociomit askush nuk kemi me të bë ankesë, merri 3, jepja njëherë, përfundoje shkollën, paret i ke dhe këtë këta deputet nuk e kanë ngritë. Këtë e di që e kanë ngritë si çështje, por me thanë unë e lëshoj, nuk ta votoj dhe arsya pse nuk ta votoj është vetëm 1, shkolla e Pozheranit.

znj.Liridona Bislimi: Shum mirë që po e thu, pe mësoj kryeministrin e ministrat si shembull po e marrë, por a është kjo shkollë që është fillu në kohën e qeverisjes së juaj, qoftë në nivelin lokal qoftë atë nacional. Pse këto kritika që po i bëni Ilir, këto ankesa e sygjerime kaq të mira që po dini me i bë për Lëvizjen Vetëvendosje, pse nuk ka ndodhë në kohën e LDK-së.

z.Ilir Zuka: A je e sigurt që nuk ka ndodhë?

znj.Liridona Bislimi: Po pse u vonu shkolla?

z.Ilir Zuka: Prej 2016 deri në 2023 ne si Pozheran pa politik po flas, nuk jam i interesum me gjetë fajtorin, por jam i interesum me u kry shkolla, se ne po e dimë.

znj.Liridona Bislimi: Unë sa here kam shku në kohën kur ke qenë ti administrator i fshatit dhe ka qenë LDK-ja në pushtet këtu, po por edhe në nivelin nacional, unë nuk e di njëherë prej banorëve të fshatit që e ka pas zërin kaq të ngritur. Unë po të kuptoj që e ke për të mirën e qytetarëve, por beso ndoshta edhe është tu tu keqinterpretu prej jashtit. E ke pas afatin kohor, mjetet, mundësitë të gjitha udhët qel, nuk e ke kry tu bënen disa vjet, tani po vjen një pushtet tjetër, po ta gjenë kërsh, ai duhet me kry, por ai lëmshi që është aty ne e kemi gjetë nuk e kemi kriju.

z.Jakup Demiri: Ilir, unë ta kam bë një pyetje, ta kanë dhanë një informatë nëse nuk e ke pas. A je taku ndonjëherë me Shpend Musën me diskutu.

z.Ilir Zuka: Patjeter.

z.Jakup Demiri: Pse kurr nuk ma ke thanë.

z.Ilir Zuka: Jakup, kemi diskutu,

z.Jakup Demiri: Para 1 viti të kam thanë që, është Shpend Musa para zyrës dhe deri para 1 muaji 1 vit

drejtë. Unë jam tu të pyet: a ke bisedu me atë njeri?

z.Illir Zuka: Po, 100 here. E dinë deputetet e tu, Jakup Demiri nuk po bëhesh ferë, në mënyrën më të sinqert ti kam pritë 2 deputet në Pozheran si administrator jo si asamblistë.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Nuk ta kam thanë për politikë. Në rastë se i ke përcjell kur kanë qenë deputet në Kuvendin ku i mbajmë ne seancat edhe të partisë sime, edhe PDK, PSD në atë kohë i kam thanë, me qenë Hasan Aliu në vend të juajin, pa e shti këtë nuk e kisha votu buxhetin edhe në rastë se me përjashtojnë prej partisë. Bile Zenun Pajaziti ashtu i kam thanë, i njëjti jam edhe sot dhe vazhdoj me qenë deri në përfundim,

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këtë punë e kemi bë temë çdo seancë, asnjë punë, përgjegjësi ne nuk e kemi pas më shumë, dhe krejt jemi angazhu për këtë punë prej fillimi. Procedura ka shku e ka fitu, ka të drejtë ankese, ka bërë ankesë, ka të drejtë me u shqyrtu. U shqyrtu, është kthi në rivlerësim e rivlersojmë neve na ka dëmtu, ne e kemi shfrytëzu tu e gjujt njëri tjetrin në fushatë kemi me gjujtë sa të duash për të, por parimisht nuk është e ndershme. Në çdo seancë me u marrë me të, se nuk i kemi fuqitë asnjëri dhe unk mundet asnjëri me bë më shumë. Unë mendoj se të gjithë e kanë dhanë kontributin. E di që nënkryetari ka qenë sdi sa here aty, e di që Jakupi mundet me shty kolegialishtë që ka njerëz aty me bisedu, asnjë veprim nuk mundet me bë, as nuk kemi mujtë me bë kur kemi qenë ne PDK-ja as LDK-ja, se ata kanë procedura të tjera. Ata menaxhojnë me buxhet miliona ai nuk e ka gjaje për 700 mijë euro për shkollë, ndoshta i ka 100 shkolla në nivel Kosove në gjysmë.

z.Ramadan Deliu: Një pyetje për nënkryetarin, prej shkollës, rrugës së Begunces deri te udha Ramnishtës, asnjë shtëpi aty nuk ishin të kyqta në ujë dhe nuk i kanë lanë mu kyqë.

z.Hasan Aliu nënkryetar i Komunës: Ata në radhë të parë duhet më bë kërkesë në "Hidromoravë" dhe kur bëhet kërkesë. Ata e marirn dhe arsyeshmërinë pse, sepse kompetentë për këtë çështje është "Hidromorava". Tani pse nuk i kanë lanë unë për seancën e ardhsmë mundem me ta pru të plotë, por me siguri nuk është plotësu ndonjë kriter.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit! Materialin e keni marrë me kohë, nuk kemi mujtë me procedru, sepse na u ka vonu në protokoll çështja e informatës së Drejtorisë së Arsimit, që kemi pas për këtë seancë, sot na ka ardhë. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024 kjo është me planin e Kuvendit për 2023. Tek rendi i ditës e kemi dhe janë raport që na ka ardhë i vlerësimit të dëmit. Një komision i formuar nga kryetari i komunës dhe vlerësimi i dëmeve. Një vlerë 98 mijë e 926.90 euro, një raport që janë vlerësu dëmet. Ky raport ka ardhë sot, këtu thotë 34 kërksa kanë qenë për vlerësim të dëmeve. Nuk e di sa ka qenë informimi për kërkesa, sepse dëmtime ka jashtëzakonishtë të mëdha, nuk jan vetëm 34 persona, po kjo pikë na ka ardhë si raport dhe nuk e di a ka mundësi të jetë me u vlerësu dhe pjesa tjetër e njerëzve tjerë apo do të jetë e mbyllur, ka qenë afati i kërkesave, nuk kanë bërë kërkesa dhe kanë mbetë. Një vlerësim i dëmeve vetëm për 34 vetë ndoshta na qetë keq tek shumë fermer të tjerë. Si raport neve na ka ardhë, sepse e dimë që kryeministri e ka nda një buxhet për pagesën e dëmeve. Për këtë kemi parapa këtë dhe një pikë e tretë, propozim për caktimin e normave tatimore për pronat e paluejtshme për vitin 2024, këtë e konsultum dhe me Fatlumin. Parimisht ky vendim nuk na ka ardhë në rregull me shqyrtimin e ligjshmërisë nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 30.10.2023 e miraton këtë. Kjo datë as nuk është sot as nuk e kemi miratu parimisht, kjo ka ardhë keq.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Vetëm i kthen e thirrë atë Xhelalin dhe i thu, shko harmonizoje, nuk kemi çka bisedojmë, nuk e ka sjellë në rregull për shkak se e ka pas edhe mungesën e Zyrës Ligjore.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi diskutimin me këto pikat që i prezantum. Kjo pika e fundit nuk shqyrtohet, mbetet për seancën e ardhshme.

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-shtator 2023.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, kompanisë KEDS J.S.C për vendosjen e trafove elektrike.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik.

Vendimit me Nr.01-110/05-993, të datës 28.07.2023 për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues.

6. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS-ë gjatë vitit 2023.

7. Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për nëntëmujorin 2023.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi diskutimin me këto pikat që i prezantam. Kjo pika e fundit nuk shqyrtohet. Mbetet për seancën e ardhshme, pra, e qes në votim rendin e ditës. Nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për procesverbal. Pasi që nuk ka, a jeni me ngritje të dorës që të miratohet. Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar-Shtator 2023

z.Berat Zuka, zyrtar i lartë financiar : Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Sektori i buxhetit i Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhivllim në kohë ka përgatitur raportin financiar që është në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, raportet 3-mujore, konkretisht janar-shtator për vitin 2023. Pjesa e parë është aprovimi, pjesa e dytë alokimet të buxhetit i keni të gjitha kategoritë dhe fondet burimore që e përbëjnë në total alokimet e buxhetit prej 12 milion e 781 mijë e 946.75 euro, mirëpo pjesa e shpenzimeve radhitja e tabelës 4 i keni të gjitha shpenzimet të cilët janë bërë në këtë 9-mujor në kategorinë ekonomike dhe fondet burimore. Është ndoshta për tu habitur fakti se te pagat është shuma 100.71% e shpenzimeve, nuk është për mu habitë, sepse këtu kemi të bëjmë me Ligjin e ri të Pagave, që Kuvendi për 9-mujor e ka tejkalu shumë e buxhetit sa ka qenë e planifikume për pagesat e anëtarëve të Kuvendit dhe Ministria e Financave ka bërë alokim të parakohshëm që edhe në drejtori të tjera kemi me planin e 1 të 12 kemi minuse për shkak të ngritjes së shumës së pagesës së pagave, mirëpo deri në fund kjo për herë të parë atakohemi me një përqindje prej 100.71, do të thotë kemi pagu më shumë se sa kemi pas, por në kuadër të planit vjetor të pagesave. Materialin e keni marrë me kohë, që të mos ju marrë kohë, të gjitha i keni të preznatuara në material. Për çdo pakjartësi jam në dispozicionin tuaj, mund të bëni pyetje.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Një pyetje Berat, tek faqja 3, shpenzimet kapitale 1 milion e 774 mijë e 524.67 buxheti i pashpenzuar 2 milion e 878 mijë. Tani i pashpenzuar është shumë më i madhë se sa i shpenzuar, ndërsa reazlimi 58%.

z.Berat Zuka, zyrtar i lartë financiar: Ne kemi këtu dhe alokim të pashpenzuar, 1 milion e 268 mijë, që afati shpenzohet për 3-mujorin e 4 të vitit 2023.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Edhe alokimi i pashpenzuar hynë në buxhet të pa shpenzuar. Tani buxheti i shpenzuar 1 milion e 700 mijë, 2 milion e 800 mijë i pashpenzuar, përqindja po na delë 58% e reazilizimit, po na del që kjo nuk është në përputhje mes këtyre dyjav.

z.Berat Zuka, zyrtar i lartë financiar: Shpenzimet e buxhetit të pashpenzuar 58% është marrë kolona e 3 me kolonën e 5 dhe kjo duhet ta definojmë pas takimit.

z.Illir Zuka: Në këtë listë mu ka dokë që është bërë një punë e mirë, se kam pas një takim me përgjegjësin e QKMF-së në Pozheran, tu e pa shumë. Po besoj që nuk është shumë e madhe dhe nuk ka asnjë mungesë dhe një faleminderim për drejtoreshën e arsimit, ka bërë punë të mirë nëpër shkolla.

znj.Liridona Bislimi: Kam disa pyetje për zyrtarin financiar, tek faqja numër 3, dua ti di shpenzimet e udhëtimit brenda vendit janë 13 mijë, ndërsa shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit janë 10 mijë. Normalisht shpenzimet jashtë vendit kanë qenë më shumë më të madhe, tani pse kësaj here ka ndodhë që brenda vendit me pas shpenzimet më shumë. Tek shpenzimet e vogla, shpenzimet jashtë vendit me sa e kuptova ish kodë i ri, sepse në fund te krahasimet që janë bërë me vitin paraprak, ky kodë ka qenë 00 e këtë vit nuk është shumë, por besoj që keni vendos si kodë të ri. Tek Zyra e Kryetarit e kemi shpenzimin e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, tek lista e kodeve të përgjithshme e pamë një listë që ke jashtë vendit, tani dhe brenda vendit, por te kryetari nuk po figurojnë brenda vendit. A ka udhtu kryetari brenda vendit dhe a

është -12. Po më intereson me ditë kjo diferencë pse ka ndodhë. Njëjtë e kemi dhe tek lejet e ndërtimit, tek taksat për legalizim, sidomos tek lejet e ndërtimit kemi zbritje -71 mijë. Pse kanë ndodhë këto? Tek faqja 20, 8.1 participimi dhe shëndetësia -34 mijë dallimet me vitet paraprake. Pse ka ndodhë diferencë kaq e madhe? Pjesa dërmuese e investimeve janë në minus, diferenca tek faqja 21 për vitin paraprak tek të hyrat nga çerdhja e fëmijëve qenka 5 mijë euro. Po më intereson me ditë a ka ramje të nxënësve pse ka ndodhë. Dhe tek inspektimi sanitar, të hyrat 20 euro për vitin 2022, të hyrat për vitin 2023 00. Diferenca është 20. Të hyrat nga inspektimi pi bjen 00 për 2022, 00 për 2023.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Këshilltare, tek të hyrat nga çerdhja i ke më shumë këtë vit, 25827 në 2022, ndërsa në vitin 2023 e ki 30981 apo në diferencë i ke më shumë 5154. Më fal për ndërhyrjen.

znj.Liridona Bislimi: Te faqja 22, totali i shërbimeve publike tek shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore, d.m.th prej vitit paraprak ka qenë 10 mijë, tash është 00. Tek dënimet e trafikut është diferenca -67 mijë, dhe të hyrat nga Zyra e Prokurimit, konfiskimi i sigurimit tenderit tek pika e 4-ër është diferencë e madhe. Këtë vit e kemi 00 me vitin paraprak. Krahasimi i shpenzimeve për vitin 2023 me të njëjtën periudhë për vitin 2022, kodi 13420 tek shpenzimet e përfaqësimit, avukataturë për vitin e kaluar ka qenë 00. Këtë vit është 12 mijë. Tek shërbimet e ndryshme shëndetsore është dallimi 154 mijë, kodi 13430, shërbime shtypje jo marketing 6 mijë ka qenë vitin e kaluar, 36 mijë është për këtë vit për kodin e njëjtë për periudhën kohore të njëjtë. Një dallim shumë i madhë. Tek shërbimet teknike 19470, 1 mijë ka qenë vitin e kaluar, 13 mijë është këtë vit. Njëjtë ka ndodhë furnizim me kompjuter. Është mirë me ditë një sqarim, sepse është një dallim shumë i madhë. Tek pajisjet tjera, dallimi është 100 mijë, furnizimi për zyre diferenca shumë e madhe. Nëse nuk mundem me pas sqarim, tani ka me kërkua dhe qasje në dokumente zyrtare, për shkak se diferenca furnizimi me pije është +16 mijë, furnizime pastrimi +11 mijë euro, furnizim me lëndë djegëse dru është +57 mijë euro. Shpenzime për informim publik vitin e kaluar ka qenë 00, këtë vit është mbi 22 mijë euro. Dreka zyrtare i keni +10 mijë euro diferencë. Shpenzime, vendime të gjykatave +25 mijë euro diferenca me vitin e kaluar.

z.Jakup Demiri: Një pyetje për nënkryetarin: pse nuk kemi drejtor të financave? Këtu tek Zyra e Kryetarit është edhe e gjetë e auditorit, kontratat mbi vepër. A qëndron ende ashtu? Se tek furnizimet ashtu duket dhe këta çka ju duhen Komunës dhe çfarë shërbime bëjnë janë edhe disa këshilltar që paguhen, nuk e di çfarë pune bëjnë dhe kush janë këta këshilltar.

z.Berat Zuka, zyrtar i lartë financiar: Sa i përket pyetjes së parë, Liridonë, shpenzimet e udhëtimit zyrtar. Edhe një here kryesues, është e pamundur në kohë të shkurtë të përgatitet kjo lista plotësuese, se këtë listë plotësuese specifikohen shpenzimet, mirëpo kohën e kemi të mangët, mirëpo nëse hymë në pasqyrat e egzekutimit në secilin program shihen ku i ka shpenzimet çka i ka tek 13130. P.sh.: shpenzimet e udhëtimit brenda vendit në kllapa e kemi transportin e nxënësve që është obligativ komuna, aty bënë pjesë dhe ansambli, këta e përbëjnë shumën prej 13371. Tek kodi 13132 është folë për 2512 euro janë shpenzimet e udhëtimit brenda vendit akomodimet e asambleve nga shtetet e tjera të "Flakadanit të Karadakut". Tek planifikimi mos të hymë Liridonë, se unë i gjeta vetëm tek inspeksioni sanitar. The, vjet ka pasë sivjet nuk ka. Inspektori sanitarë nga gjysma e vitit të kaluar është dalë në agjencionin gupit, më nuk kemi shpenzime sanitare, po për shkak të krahasimit të shpenzimeve nga viti 2022, sepse në vitin 2024 nuk do të funksionoj se edhe planifikim të tyre ka se inspektor sanitar. Inspektori i veterinarisë dhe inspektori tjetër nuk janë më pjesë e komunës sonë, po për shkak të korrektësisë dhe raportit financiar, është qitë edhe viti 2022. Po në vitet e ardhshme nuk dotë jetë, se nuk është e planifikum. Tek krahasimi i shpenzimeve, pse një vit më të mëdha për ato. Unë nuk mundem me dhanë atë shpjegim, varet nga autorizuesit e buxhetit, nga specifikat varet për qdo vit se ka i orientojnë shpenzimet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Po lidhem tek kjo çështja që ke diferenca tek urbanizmi. Urbanizmi këtë vit ka bërë planifikim më shumë për shkak që ka pas kërkesa shumë për legalizim, mirëpo legalizimi nëse nuk ka ndodhë, ai nuk e ka pagu. Ti e ke bërë planifikimin, se në momentin që e bënë kërkesën për legalizim, tani që është shty afati, tani ti bënë kërkesa, mirëpo pagesa nuk bënë pa u kry procedura, mirëpo ti duhesh mi planifikimi, se tani nuk mundesh mi mbledh të hyrat.

z.Berat Zuka, zyrtar i lartë financiar: Gjatë prezantimit të buxhetit kemi thanë se, planifikim i të hyrave vetanake komunale nuk është real. Pse në qarkoren buxhetore neve na kushtëzohen me pas planifikim më të vogël sesa planifikimi i drejtorëve të cilët e dinë dhe atëhere duhet. Tatimi në pronë, në tokë duhet patjetër ne mi qitë shifrat, se duhet me i qitë në investimet kapitale në qarkoren buxhetore dhe Ligjin e Buxhetit, kurse

vogël se për çdo vit. Ne po kemi rritje. Në vitin e kaluar kemi pas 195 mijë euro rritje, duke i përfshi edhe të hyrat indirekte të nivelit qendror që po paguhet gjykata dhe trafiku rruigorë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Edhe tek të hyrat vetanake ne e planifikojmë për vitin e ardhshëm. Kur po i mbledh borxhet e akumulume më herët ai po ta tejkalon. Atëhere pse nuk po bëhet kjo ndarje. Ne duhet me dallu, ky është borxh i viteve paraprake, ndërsa ky është i vitit aktual që je.

z.Berat Zuka, zyrtar i lartë financiar: Po ka mundësi tek tatimi në pronë dhe tokë, ka mundësi këtë me prezantu. Borxhet në pasqyrat financare të nivelit qendror që i prezantojmë, mundeni me i pa në web faqe. Atje duhet me i perzantu patjetër edhe borxhet plotësohen me individ në atë tabelën plotësuese, se jo vetëm si total i borxheve. Ato janë tabela shumë të gjëra për auditorin, kurse për neve në të ardhmen duhet një angazhim, por në raportet 3-mujre është pak problem edhe për zyrtarin se ka obligime të tjera me dalë në teren me i angazhu punëtorët. Është problem të punohen për 15 ditë, sepse për 15 ditë shënimet nuk përpunohen edhe të nivelit qendror. Ne i kemi prezantu raportet financiare me 15 janar, me 30 janar janë bërë, por në fund të shkurtit na kanë ardhë edhe 2/3 her të hyrat nga ambasadat ose të hyrë tjetër nuk kemi pas mundësi me përmirësu ai raport ka shku si raport -2 euro se kemi dhe mekanizma të tjerë që na kontrollojnë.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Kjartësimi i këtyre kodeve sikur të ju kishte shku me kohë këshilltarëve edhe pyetje kishë pas më pak. Pjesa dërmuese e pyetjeve që janë bërë janë të zberthyme këtu. Një rast është tek çështja e shpenzimeve të avokaturës. Liridonë, e ke të zberthyme këtu në shtojcë që ta ka dhënë. Zakonisht janë te përmbuesit privat të cilat janë pagu te tatimi në pronë. Tatimi në pronë e ka rritë edhe atë planin të cilët e kanë parapa këta të cilët kanë kufizime të cila ti tha edhe zyrtari financiar. Unë konsideroj që, Komuna e Vitisë sivjet do ta ketë 130/140% më të lartë nga ajo të cilët e kemi parapa. Tani veç 9-mujor e kemi diku 104%. Tek krahasimi i shpenzimeve i kam parë dhe unë, por zakonisht shkoj tek shuma e përgjithshme deri sa në vitin e kaluar i kemi pasë 11 milion e 16 mijë e 594 sivjet, ndërsa vitin e kaluar e kemi 1 milion e 627 mijë. Tek kjo diferencë e ke të kjarësum këtu se, është diferenca dhe mes pagave, mëditjeve, plus kësaj ta përcakton ofertuesit si kanë konkuru dhe një prej tyre ki me zgjedhë, është ndryshimi i çmimeve e cila ta bënë diferencën prej vitit në vit. Nuk ka vit të cilët mundim me pas shpenzimet më të vogla. Çdo vit kemi mi pas më të mëdha për shkak se trendet janë në atë formë. Unë konsideroj se të gjitha ato që i merrë në Kuvend ti mundesh me i kërku qasje në dokumente, por po ju themë me sinqeritetin më të madh, një kërkesë e juaja apo e qytetarëve për qasje në dokumente publike për 3-4 ditë 2/3 zyrtare i qetë jashtë përdorimit. Jakup unë besoj se së shpejti do ta kemi drejtorin, pak jemi vonu, por megjithatë është e drejtë e kryetarit në hulumtim të gjetjes së një drejtori në aspektin profesional do ti përmbush ato premtimet e kryetarit të cilët gjithëhere i mbanë. Është një drejtori shumë specifike, nuk është e lehtë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të komunës kompanisë KEDS J.S.C për vendosjen e trafove elektrike.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo afatëgjatë jeket, sepse është një gabim në Kuvend. Vjen vetëm dhënie në shfrytëzim. Ata i kanë parapa, i kanë bërë matjet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Pronat e paluajtshme, neni 5 e cekur në nenin 2 të këtij propozim vendimi jepet në shfrytëzim jo pa kompenzim. Unë kam hulumtu shumë. Nëse ne i thojmë pa kompenzim, ne i lidhim këmbët tona dhe më kurrë nuk mundemi mi lypë nënkryetarë. Tani kemi me thënë prona e paluajtshme e cekur në nenin 2 të këtij propozim vendimi jepet në shfrytëzim sipas ligjeve në fuqi dhe sipas ligjeve në fuqi ai e ka me kompenzim.

znj.Majlinda Ostroglava, drejtoreshë: Këtë e kam lënë pa kompenzim, sepse do komuna e bëjnë me pagesë, disa pa pagesë. Unë kam thënë me u konsultu dhe e lëjmë me pagesë si të doni.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne këtu thirremi në bazë të ligjit, neni 27, pika 3 thotë: kushtet në vijim që aplikohen në raport me të drejtën e shfrytëzimit, komunat dhe autoritetet tjera publike mund të mbledhin taksa dhe tarifa nga ndërmarrja energjisë në të njëjtën mënyrë dhe të njëjtën shkallë sikurse ndërmarrja e energjisë që ishte pronari i pronës. Këtë fjalën kompenzim nuk guxojmë me lënë.

znj.Majlinda Ostroglava, drejtoreshë: Tek Ligji mbi Dhënien në Shfrytëzim është tek rastet e veçanta

me interes, por edhe me pagesë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Nuk e lëjmë për Kuvend, menjëherë e ndërrojmë. Prona e paluajshme e cekur në neinin 2 të këtij propozim vendimi jepet në shfrytëzim sipas ligjit. Përfaqësuesi i KEDS-it i thotë kryetarit të Komunës, unë ty ka me t'i ndreqë 5 trafo dhe është interesi im, unë nuk e la me pagu hiq, por ai më zhagitë për një kërkesë. 100 kërkesa i kanë pas Gërmova e Skifteraj, e nuk po ma ndreq trafon. Nuk ka pa pagesë.

z.Ramadan Deliu: Unë kisha thanë këtë afatshkurtë me hekë me bë afat të pacaktuar dhe me bë pagesa, sepse ai nuk ta jep falë rrymën.

z.Illir Zuka: Po besoj se një nder pikat kryesore këtë vit është kjo, tu i ditë problemet e qytetarëve si me rrymë, si me rrugë. Për atë është një ndër pikat kryesore. Unë e di që edhe në Sllatinë të Poshtme, te familja e Hoxhëve janë 22-23 shtëpi. Nuk e di a i keni shti këtu dhe këtu u kanë mirë mi cekë, sepse vetëm Sllatinë. Ne në viti nuk kemi ose është aty i është shtru asfalti. Kanë jashtëzakonisht shumë nevojë. Në stinën e Dimrit nuk kanë rrymë hiq.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Kjo është kërkesë e KEDS-it.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Të gjitha kërkesat që janë bërë, KEDS-i e ka bërë atë studimin e vetë që i ka. Këto janë që janë leju prej Prishtinës, ata i kanë miratu këto për këtu. Tri në Buzovik janë shumë për një fshatë të vogël mi vendos tri trafo, mirëpo kjo shtë një kërkesë prej qendrës që i kanë leju ata. KEDS-i ka kërku mi lëshu këto vende për me vendos trafo. Unë e di se janë diku 40 kërkesa që ka me i pas Viti. Faza e parë janë këto 15. Drejtoreshë, këto nëse i lëjmë në afatshkurtë, nuk do të thotë që është 15 vjet, se afatshkurtë mundet me qenë edhe 3 edhe 5 vite nëse e caktojmë ne duhet me përmend. Nëse e lëjmë vetëm dhënie në shfrytëzim, parimishtë ne duhet me ja caktu për sa ja japim dhe kjo pika 5, domethanë dhënie në shfrytëzim sipas ligjit në fuqi e jekum pa kompenzim. KEDS-i për çdo shtyllë elektrike një kabëll që e vendos të rjetit i merrë 80 centë. Komuna e ka ndriçimin publik nëpër shtylla elektrike. Komuna duhet me u ulë mi specifiku me KEDS-in në momentin që KEDS-i është privatizua shtyllat ku i ka pas nuk mundet me i ngarku me qira, se ata i ka ble. Ashtu prej asaj dite çdo vend që është dhanë mundet me i ngarku. Nëse ne e shtimë në pagesë, ai mundet me të shti ty në pagesë edhe për ndriçim publik që i ke vendos ato, mirëpo duhet me u ulë me bë një marrëveshje Komuna me KEDS-in mi specifiku gjërat që i shfrytzojnë së bashku.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Drejtoreshë, është me rëndësi që Kuvendi është tu shku konform kërkesave të tyre. KEDS-i momentalisht nuk është tu shku konformë qytetarëve tanë, këtë e din edhe kryesuesi, edhe Jakupi ka qenë që nga mandati i parë. Në mandantin e parë kur kam qenë nënkryetar, nuk ka pas kërkesë të qytetarëve të Vitisë që ka zgjatë mbi 3 muaj që ata nuk e kanë bërë trafon, dhe prandaj kjo punë ka ngecë. Edhe ne shërbimet të gjitha ja kemi kry. Tani është tu ngecë dhe këtë punë ne duhet me lëviz së bashku në takimin me kryetarin e Komunës. Nuk ka dashtë, u shti 1 muaj, se kryetari nuk u pajtu në bazë të kërkesave që janë, që nuk u përputh ky plan i KEDS-it me kërkesat e qytetarëve që kanë ardhë në adresë të na dhe për atë duhet me shti çështjen e pagesës.

z.Jakup Demiri: Në Kuvend Komunal votohet, por deri në Kuvend Komunal me kqyrë si pikë mirë si me harmonizua mirë, se nuk është që nuk kemi pas probleme me dokumente me KEDS-in. Ata jashtëzakonisht sillen keq me qytetarët. Unë kam pas rastë vetë në fund e kam fitu gjyqin, por unë edhe kam pësu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne të jetë 15 vite dhe ne të heket kjo pa pagesë, por le të jetë sipas ligjit. Ju lus që të votohet kjo pikë. Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet kjo pikë e rednit të ditës.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshme publik

znj.Majlinda Ostrogllava, drejtoreshë: Kemi pas 2 kërkesa për ndërrim. Është një parcelë në emër Kadri Emerllahu dhe Agron Haliti. Njëra është në Ramjan dhe tjetra është këtu në Viti tek shkollat e mesme. Këto vetëm janë tu shpallë zonë me interes. Ju këtë procedurë e dini gjithëhere. Njëhere shpallet zonë me interes, pastaj në kuvendin e ardhshëm ju vjen propozim ndarja që specifikohet sa metra katror bëhet ndërrimi e të tjera. Këto vetëm janë tu shpallë zonë me interes. Ne vetëm bazohemi në bazë të kërkesave që i kemi, i verifikojmë, që janë në kufi, duhet me qenë në pronën e komunës për me leju me vazhdu tutje.

znj.Majlinda Ostroglava, drejtoreshë: Ish në hipotekë. Nuk ka të drejtë, më duket se Hida e ka përgatitë përgjigjen me shkrim për atë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Ai dokumentacionin e ka pas shumë të kompletum. Ai kish pengesë në legalizim, ka qenë te unë.

znj.Majlinda Ostroglava, drejtoreshë: Ne e kemi diskutu dhe jemi mundu. Për mua më mirë me i shpallë 3 parcela me zonë për interes.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse ne e shpallim një zonë me interes, ne duhet me pas një arsyetim për çka jemi tu e shpallë.

znj.Majlinda Ostroglava, drejtoreshë: E ki arsyetimin për këmbim, ndërrim pronë private me pronë komunale.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Për këto 2 raste nuk i di, për Xhavitin e kam marrë se ka qenë dhe tek ne. Merre me mend, shtëpitë i kish këtu ku i kish shtëpitë po figurojke rrugë. A rruga ish qëtu dhe tani ai të njëjtën e merrë, i bënë pronë private, i lëshon këto ku është defakto rruga.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo pjesa në Ramjan e ka shpija është në rrugë dhe tani rruga është për me ik në oborr të vet me të njëjtën, se rruga ku është Kadastri i bjen midis shtëpisë. Tani rruga mu deviju me ju lështu pjesa qarkulluese.

znj.Majlinda Ostroglava, drejtoreshë: Këto parcela janë duke u shpallë zonë me interes. Tani Kuvendin e ardhshëm ju vijnë propozim ndarjet sa metra katror, sa bëhet ndërrimi, specifikohen, se këto vetëm zonë me interes qe ku janë të shenume ato parcelat. Nnk mundemi me i përcaktu sa i kemi marrë, me rëndësi është me pas kërkesën dhe arsyen se, pse jemi tu i shpallë ne zonë për interes. Arsyja është emerat e pronarëve në ato parcela dhe kërkesat i keni për këtë hëre po mendoj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne kur e kemi shpallë zonë me interes, ka qenë rrugë e Komunës. Ja ke marrë, e ke shtru asfaltin, e ke zgjeru, ti tashti e ke bërë zonë me interes ose e ke kompenzu. Për këtë duhet me u dhanë sqarimi. P.sh.: për këtë pjesën e Ramjanit e di ku është saktë që shtëpia është në mes të rrugës. Ne duhet me ditë arsyen çka jemi tu bë. A është që e kemi shpallë zonë për interes, por ka pas me hy në procedurë për shpronësim të pronave. Këtu është vetëm lëvizja, vetëm ndërrim të njëjtin vend të njëjtën parcelë, vetëm në kufi, rregullim të megjeve që i ka.

z.Illir Zuka: Unë po mendoj për këtë pikën në Ramjan. Ne si Komunë jemi vonu tu e ditë që ka sjellë shumë probleme dhe për një individ të caktum është kthy mbrapsht. Për me u mbyll krejt kjo duhet me kalu me procedurë të shpejtë që me u mbyll krejtë. Prej anës time është pro.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që kjo pikë të shkojë në Kuvend? Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet kjo pikë.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit me Nr.01-110/05-993, të datës 28.07.2023 për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse e dini, në Kuvendin e kaluar kemi thanë që, na ka ardhë tek kodet që kanë qenë të bujqësisë njëri ka qenë pozitiv. Ne njëjtë i kemi i miratu, por njëri kod nuk ka pas pare te mjaftushme brenda kodit dhe ka ardhë plotësim ndryshim tek kodet e participimit që janë.

z.Fatlum Demiri, sekretar i Kuvendit Komunal: Ministria e ka nxjerrë një udhëzues dhe për krejt komunat e Kosovës ka bërë kode të njëjta. D.m.th ja u ka dërgu Ministrisë së Bujqësisë. Drejtori ka qenë në rrjedha, e kemi konsultu dhe me Ministrin e Financave i kam dërgu këtë ndryshim plotësim parapakisht për konfirmim të ligjshmërisë ma kanë konfirumu në mes e-mailit që me shku në këtë formë me këta kode dhe kryesuesi ka vendos që me bë një plotësim ndryshim për arsye se kodet e mëparshme kanë qenë të shpenzuara. Nuk ka pas mjete dhe tani këto kodet e reja kanë mjete.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit për sqarimin! A jeni që kjo pikë të shkojë në Kuvend. Nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe kjo pikë.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS-së gjate vitit 2023

z.Valmir Sahiti, drejtori i DKRS: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Me kërkesën e kuvendit dhe

kanë qenë më të mira. Këtu hynë edhe TVSH, transporti, prerja.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Në bazë të kësaj, cila na cakton neve që janë projekte 2-vjeçare, 3-vjeçare.

z.Fadil Abazi, zyrtar i prokurimit: Këtu ja u kemi vendos titullin, por shumica janë 2-vjeçare, për shkak të planifikimit të buxhetit që është ashtu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat, kjo pikë nuk delë në votim. Vazhdojm me tjera.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Informatë e Dretjorisë Komunale të Arsimit në Viti (Fillimi i vitit të ri shkollor 2023/24)

znj.Arta Ajeti, drejtoresha: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Fillimi i vitit të ri shkollor ka fillu me 1 shtator. Ne si DKA jemi mundu që t'i bëjmë të gjitha përgatitjet nëpër të gjitha shkollat në përjashtim të shkollës së mesme Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës", që e kemi në renovim e sipër, kështu që jemi detyru nxënësat t'i ndajmë nëpër 2 objekte shkollore. Disa nxënësia i kemi tek shkolla e mesme teknike, disa nxënësia tek shkolla fillore "Dëshmorët e Vitisë". Mund të them se, të gjitha shkollat me 1 shtator kanë qenë të përgaditura jemi mundu që ato kërksa që kanë bërë drejtorat t'i realizojmë dhe ende po punojmë aty ku ka nevojë. Në këtë vit shkollor në DKA jemi diku rreth 814 punëtor që përfshihen administrat, mësimdhënës, edukatore, punëtor teknik, 9 punëtor janë tek stafi në DKA. Në klasat e para i kemi 41 paralele, gjithsej me 560 nxënës mund të themë këtë numër edhe pse sistemi SMIA për shkak të ngarkesës në të gjithë Kosovën ende nuk është përfunduar, kështu që deri të premtën ende janë në regjistrim e sipër. Tek klasat e 10 mund të them se kemi numër të nxënësve diku 497. D.m.th në 3 shkolla të mesme që i kemi, Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës", shkollën teknike po ashtu në shkollën mikse në Pozheran. Jeni të informuar që përmes MASH-tit i kemi pas librat 1 deri në 5, ndërsa 6 deri në 9 kanë qenë të trashëguara prej vitit të kaluar në bashkëpunim me drejtorat dhe mësimdhënësat thuaj se 90% e nxënësve janë me libra, ndoshta dhe ka më shumë. Jemi mundu aty ku ka shumicë të librave, ku kanë mbet t'i kompenzojmë nëpër shkolla tjera. Jemi duke i testu edhe nxemjet nëpër shkolla. Tani fillon sezona dimërore, kemi bërë furnizimin me material, d.m.th me drunj. Thuajse të gjitha shkollat janë të furnizuara, edhe pse mirë do të ishte që në vitin e ardhshëm tu punojmë me pompa termike, për shkak që këtë vit ka qenë çmimi shumë i lart i drunjëve, e vitin e ardhshëm mund të mos kemi.

znj.Liridona Bislimi: Tek rënia e numrit të nxënësve nëpër shkolla. Dua ta di, a ka pas shkolla që janë mbyll? Edhe, sa shkolla rrezikohen për me u mbyll vitin e ardhshëm në Komunën e Vitisë? Jam në diskutim e sipër me disa prind të shkollave në Komunën tonë, ku mësimdhënësit i obligojnë në një formë me ju kërku mjete, të holla për me siguru ngjyra për printer nëpër shkolla të Komunës sonë. Nuk e di kjo sa qëndron, se nuk kam pas kohë dhe hapësirë me shku vetë dhe me pa situatën, por nëse është e vërtet, unë kisha kërku prej juve me pranë si shqetësim dhe me marrë me bë një analizë se si qëndrojnë shkollat në Komunën e Vitisë me printer, për shkak se nuk është e drejtë që prindit me u obligu për me ju ofru nxënësve për me mbush printerat me ngjyra. Edhe tek materiali, pasi vjen në Kuvend dhe është prej Drejtorisë së Arsimit, vetëm mundeni me bë një rregullim tek pjesa në klasën e parë këtë vit shkollorë jan regjistruar Xh me ndryshu se nuk po delë mirë.

znj.Arta Ajeti, drejtoresha: Sa i përket humbjes së klasave, po sivjet i kemi pas 2 humbje të klasave në fshatin Tërpezë dhe Skifteraj. Tek numri i nxënësve mund ta bëjë një dallim nga viti në vit, 2021/22, kemi pas 7829 nxënësia, 2022/23 kemi pasë 7202, ndërsa tani i kemi rreth 7000. Kuptohet që nuk është shqetësimi vetëm tek ne, por në të gjithë Kosovën. Sa i përket marrjes së të hollave tek prindërit, me ligj nuk lejohet. Ne këtë informatë nuk e kemi, do të jem në kontakt me drejtorat, në takimin e ardhshëm do ta diskutojm këtë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Një problematikë është furnizimi i nxënësve me libra. Unë 4 fëmijë i kam në shkollë fillore, ende të klasës së 2-të nuk i kam kompletu, se nuk ka mi ble. Shumë here kam qenë, nuk kanë ardhë krejt. Prej klasës 6 deri 9, shkollat nuk kanë pas libra të mjaftueshme. Pse nuk kanë pas nuk e di, problemin kryesor e kemi që nuk jemi tu mujt askund me i gjetë, as në librari me i ble, që është një shqetësim dhe mendoj që duhet prap me u konsultu me drejtorat, se ka mbetë ndonjë libër dhe ne t'i kombinojmë mes vete. Ehe tek çështja e fotokopjës, unë nuk e di a i kanë lypë prindërve pare, por kjo është shqetësuese. Unë vet e kam thirr Izjadinin. Krejt shkolla teknike gjithë ato gjëra i kemi nuk e ka një ngjyrë. Telashja është me

as në Viti nuk ka funksionu, sikurse nuk ka funksionu tek librat. Unë besoj se Qeveria ka me pas parasysh dhe ka me ndërru qasjen, mos me lanë sistemin online, se ndryshe kur të merret nje drejtoreshë, drejtori i merr shkon raportin kaq nxënësia i kam dhe i qon librat në shkollë i shpërndan. D.m.th jemi në përfundim të muajit të 2-të dhe ende debatojmë. Ky po raportin se tani jemi në fazën e notimit, si e noton një nxënës që ti nuk e ke kompletu me libra. Çdo vit i cili dështon një projekt duhet me u korigju për vitin e ardhshëm. Unë besoj se këto shqetësime i kam vazhdimisht, i kam edhe tek çështja e naftës, por aty nuk kemi pas problem edhe aty i kem centralizu, niveli qendor i udhëheq ato procedura, por me një fjalë po bëhet shumë centralizim i disa shërbimeve që janë të nivelit komunal, që besoj që shumë më mirë do të kishte funksioni me ja lënë komunës

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë kisha kërku që, vetëm tabelën me ditë sa është viti me vit krahasimet sidomos për fillore.

Si pikë e nëntë e rendit të ditës:

9. Shqyrtimin dhe miratimi i Raportit të vlerësimit për dëmet e shkaktuara në bujqësi

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht kjo na ka ardh si pikë, dhe unë jam i pakënaqur. Ne me këtë raport me 34 kërkesa, dëme, kur e dimë që dëmet janë jashtëzakonisht të mëdha. Unë mendoj se, në secilin fshat me hi 34 vetë i gjenë që kanë pas dëme të jashtëzakonshme në bujqësi. Ne me këtë listë me i qu 98 mijë euro, mendoj që kemi me ra keq para krejtve. A ka mundësi që kjo listë të plotësohet? Ne e lajmë si raport, por me lanë së paku 1 javë mu plotësu ky. Nëse nuk ka afat më shumë. Ata që kanë bërë kërkesa, ata në të përfitojnë, ne nuk mundemi me i ndalë, ai çka nuk ka bërë kërkesë ai nuk përfiton. Pasi që nuk pa për debat, me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada – Government

Komuna e Vitisë

Opština Vitina– Municipality of Vitia



Bazur në nenet 58 paragrafi 1 shkronja h e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008 e datës 04 Qershor 2008, të nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2 e datës 15 Shkurt 2018, nenit 50, germa(i) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të datës 21 Prill 2011. Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë:

ROPOZIM VENDIM PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN PËR PRONAT E PALUAJTSHME PËR VITIN 2024

Neni 1 Normat Tatimore

1.Caktohen normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave në tërë e komunës së Vitisë me përjashtim të kategorisë pronë publike dhe përjashtimeve tjera sipas legjislacionit përkatës, më sa vijon:

2.Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme neni 9 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri në 1.9, dhe Ligjit nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme

3 Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, pika 1 si dhe pikat 1.1 për njësit bujqësore të parcelave, 1.2 për njësitë bujqësore të objekteve, 1.3 për njësitë pyjore të parcelave, 1.4 për njësitë rezidenciale të parcelave, 1.5 për njësitë rezidenciale të objekteve 1.8 për njësitë industriale të parcelave dhe 1.9 për njësitë industriale të objekteve, Kuvendi i Komunës së Vitisë cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronave publike, me sa vijon:

1.1 Për njëstë bujqësore të parcelave-----	0.20%
1.2 Për njëstë bujqësore të objekteve-----	0.20%
1.3 Për njëstë e pyjeve të parcelave-----	0.20%
1.4 Për njëstë rezidenciale të parcelave-----	0.20%
1.5 Për njëstë rezidenciale të objekteve-----	0.20%
1.6 Për njëstë komerciale të parcelave-----	0.17%
1.7 Për njësi komerciale të objekteve-----	0.17%
1.8 Për njëstë industriale të parcelave-----	0.20%
1.9 Për njëstë industriale të objekteve-----	0.20%

Neni 2 Zbatimi


Për zbatim të këtij vendimi obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – Sektori i Tatimit në Pronë.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky propozim - vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe i njëjti fillon zbatohet nga data 01 Janar 2024

Viti më _____





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Prillëzim - Prilježje ME/Dana 08-11-2023

11-016/01-1342



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipal Vitina

Datë	08.11.2023
Për	Kuvendin Komunal- Komuna e Vitisë
Nga	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
Tema	Informatë rreth procesit të Legalizimit në Komunën e Vitisë

Me ligjin 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa leje i vitit 2018 i cili ka paraparë afatin e aplikimit për legalizimin e ndërtimeve pa leje gjatë periudhës 2018- deri më 4 shtator 2022, i ndryshuar dhe plotësuar nga ligji 08/L-184 që ka zgjatur afatin e aplikimit nga 1 shtatori 2023 deri më 31 dhjetor 2025.

Të dhënat e paraqitura në tabelë janë aplikime gjatë afatit të parë, kurse tani pas ndryshimit dhe plotësimit të ligjit dhe zgjatjes së afatit për aplikim nuk kemi pasur ndonjë aplikim përveq informatave të qytetarëve të cilët kanë kërkuar në Drejtorinë e Urbanizmit rreth procesit të legalizimit.

Drejtoria e Urbanizmit së bashku me USAID-in dhe Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka organizuar fushatë informuese për qytetarët duke vendosur një shtand në qendër të qytetit ku janë shpërndar fletushka me informacione për procesin e legalizimit, gjithashtu përmes faqes së komunës në facebook dhe mediave lokale.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për legalizim të objektit janë:

1. Formulari i Aplikimit
2. Dëshmia për pronësin e parcelës



3. Matjet Gjeodezike nga Gjeodeti i licensuar
4. Deklarata e pronarit të ndërtimit për përgjegjësin lidhur me strukturën e ndërtimit.
5. Kopja e leternjoftimit

Raporti i Përgjithshëm					
15 Korrik 2019 - 30.10.2023					
	Numri i Aplikimeve	Vendime për Listë të Pritjes	Vendimet për Listë Rrënitimit	Vendime për Certifikatë të Legalizimit	Vendime të Regjistruara në Kadastër dhe RDPP
Numrat e regjistruar ne komune	209	11	--	128	80

-Kategoria II: 12 objekte te Legalizuara



Drejtori i DUPMM

Visar Demiri



Republika e Kosovës

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
 Nr. 10
 Datë: 09.11.2023
 VITTI

Pranuar / Prillogur / Më Dërguar	Prillogur / Më Dërguar
Nr i organit	Numri/Broj	Shënjestra	Vendi
Org.broj	Prillog	Vendi	Vendi

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Komuna e Vitisë

PLAN I Operativ për mbjelljet vjeshitore për vitin 2023 – 2024

N r.	SEKTORI	KULTURA	Sip. e plantif. për ha	Rendime nti i plantif. për ha	Sasia e farës për ha	Sasia e plehut për ha	Gjithësej sasia e farës në ton	Sasia e NPK dhe NAG 50%-50% ton	Lëndë djegëse për ha	Gjithësej Lëndë djegëse në L
1	INDIVIDUAL	GRURË	3614.88	5000 kg	300 kg	350 kg	1,084.464/ ton	1,265.208/ ton	40 L	144,595.2 L
2	INDIVIDUAL	ELBË BIRRE	3	3000 kg	200 kg	300 kg	600/kg	900/kg	40 L	120 L
3	INDIVIDUAL	THEKËR	2	2500 kg	250 kg	300 kg	500 /kg	1000/kg	40 L	80 L
4	INDIVIDUAL	BIMË FORAXHË RE	28	4000kg	50 kg	300 kg	1400/kg	840/kg	40 L	1,120 L
5	INDIVIDUAL	TËRSHËRË	7.82	2500 kg	200 kg	200 kg	1564/kg	1564/kg	40 L	312.8 L
	GJITHSEJ		3,655.7/ ha							146,225/L

13.11.2023
 09.11.2023
 VITTI

Drejtori i Bujqësisë

Naim Pira